



0692061961

Ibrahim

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMUNA NIKEL**

Komuna Nikel Adrese: Qender Nikel Fush/Kruje Tel +3555640075 www.komunanikel.gov.al

**KONTRATE PER MBIKQYRJE PUNIMESH**  
**“Rikonstruksion Shkolla e Mesme Ramazan Karaj”**

Nr. 936 prot

Date 29 / 09 / 2014

Nenshkruar ndermjet Komunes NIKEL perfaqesuar nga Kryetari i saj Z. Rrahman Rraja i quajtur “Investitori” dhe bashkimit te shoqerive IMES-D shpk me numer NIPTI K82430006C dhe me Licence MK.1641/3 “Per Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi” & KLODIODA shpk me numer NIPTI K51813002H dhe me Licence MK.0773/7 “Per Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”i krijuar me kontrate bashkepunimi te perkoheshme te shoqerive nr 2724 rep nr 783 kol date 28.09.2014 me perfaqesues me prokure te posacme nr 2725 rep nr 784 kol date 28.09.2014 nga shoqeria IMES-D shpk perfaqesuar nga administrator i saj Z. Ibrahim Dragoshi i quajtur tani e tutje “Mbikqyres Punimesh Zbatimi”

**I.OBJEKTI**

Mbikqyrjen e punimeve ne objektin: Rikonstruksion Shkolla e Mesme “Ramazan Karaj” Vlera e kontrates per mbikqyersin e punimeve ne kete objekt eshte 1 nje lek pa TVSH dhe 1.2 nje pike dy lek me TVSH sipas njoftimit te fituesit ne tenderin per blerje me vlere te vogel me objekt prokurimi Mbikqyrjen e punimeve ne objektin: Rikonstruksion Shkolla e Mesme “Ramazan Karaj” i zhvilluar me date 26.09.2014 ku ky operator ekonomik u rendit ne vendin e pare sipas gjenerimit te sistemit elektronik ku renditet ne vendin e pare oferta ekonomike me cmim me te ulet.

**II. VENDI I NDERTIMIT**

Vendi i kryerjes se punimeve eshte prane fshatit Nikel te Komunes Nikel, Rrethi Kruje, sipas projektit.

**III. BURIMI I FINANCIMIT**

Burimi i financimit per fondin e mbikqyresit te punimeve te zbatimit ne shumen 1 nje lek pa TVSH dhe 1.2 nje pike dy lek me TVSH jane fonde qe disponohen nga investitori.





#### IV. AFATI I KONTRATES

Afati i kontrates shtrihet paralelisht me afatin e kontrates se lidhur ndermjet Investitorit dhe sipermarresit per zbatimin e objektit duke perfshire ketu edhe shtyrjet e mundeshme qe lindin gjate zbatimit te kontrates.

#### V. GJUHA DHE LEGJISLACIONI


Gjuha e perdorur ne formulimin e kontrates dhe te çdo dokumenti tjetër lidhur me te eshte gjuha shqipe ndersa ligji dhe aktet qe aplikohen per çdo gje lidhur me kete kontrate eshte lagjislacioni Shqiptar ne fuqi ku prevalojne Kodi Civil i RSH neni 850 e ne vazhdim, ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", ligji nr 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" me ndryshimet perkatese, Udhezimi nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve ne nderimit" me ndryshimet perkatese, ku mbikqyresi i punimeve mban pergjegjesi sipas dispozitave ligjore ne fuqi per rrespektimin dhe mosrrespektimin e tyre

#### VI. KOMUNIKIMI

Komunikimi midis paleve nenshkruese te kesaj kontrate do te behet vetem me shkrim. Njoftimi behet efektiv vetem pasi te dorezohet.

#### VII. PERGJEGJESIT E DREJTUESIT TE PUNIMEVE

1. Mbikqyresi i punimeve nuk duhet te kete lidhje pune, lidhje gjaku apo interesash as me sipermarresin dhe as me kolaudatorin, ai nuk duhet te kete asnje pengese te ketij loji me projektuesin, per kete qellim mbikqyresi i punimeve duhet te bej nje deklarate me shkrim Investitorit.
2. Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat me kryesore librin e kantjerit dhe eshte pergjegjes per saktetin e vertetesin e dokumentave qe pasqyrohen ne te.
3. Me rastin e fillimit te punimeve, mbikqyresi duhet te beje verifikimet paraprake si me poshte vijon:
  - a. Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet.
  - b. Njohjen me hollesi te kontrates se sipermarrjes dhe e te gjithe akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjithe ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
4. Mbikqyresi i punimeve, pas verifikimeve te percaktuara ne pike 3, harton dokumentacionin e meposhtem:
  - a. Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit te sheshit te ndertimit shoqerise Sipermarrese.
  - b. Aktin e dorezimit nga sipermarresi te dokumentacionit teknik dhe administrativ si Licensa (Drejtues ligjor, drejtues teknik te objektit), autorizime e leje te marra nga sipermarresi.
  - c. Shkresen me anen e te ciles njofton investitorin per fillimin e punimeve.





5. Mbikqyresi i punimeve duhet te raportoj me ane te nje relacioni me shkrim prane Zyres se Planifikim Teritorit te Komunes Nickel cdo dite te premte te cdo jave per ecurine e punes ne objekt, ne rast mosparaqitje te relacionit do te penalizohet per shkelje administrative ne zbatim te nenit 15 te ligjit nr 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" i ndyshuar

6. Mbikqyresi i punimeve IMES-D shpk perfaqesuar nga Z. Ibrahim Dragoshi do te firmose dhe vulose te gjithe dokumentacionin edhe per ato pika te licances qe ky subjekt nuk i diponon ne licencen e tij, por ne baze te kontrates se bashkepunimit si dhe ne baze te prokures se posacme ,shoqeria KLODIODA shpk i njeh te gjitha veprimet qe do te kryeje shoqeria IMES-D shpk te drejta dhe si te kryera nga KLODIODA shpk

7. Mbikqyresi i punimeve, gjate zbatimit te punimeve, i jep instruksione dhe urdhera me shkrim sipermarresit sa here qe e sheh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe ky i fundit eshte i detyruar ti respektojeto ato, por duke ruajtur te drejten ti beje me shkrim investitorit vrejttjet e tij, per instruksionet dhe urdherat e mbikqyresit te punimeve.

8. Mbikqyresesi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i sipermarresit. Per te realizuar kete, ai i drejtohet me shkrim titullarit te shoqerise sipermarrese, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore te propozimit per largim mund te jene moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftesia, arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.

9. Materialet qe vine ne objekt duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit teknik. Materialet ne objekt perdoren vetem me miratim te investitorit dhe mbikqyresit te punimeve. Materialet te ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipermarresi, por qe nuk pranohen nga investitori dhe mbikqyresi, zevendesohen me te tjera me shpenzimet e sipermarresit. Ne kto raste (si per materialet, ashtu edhe per pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me proces verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare dhe atyre evropjane.

10. Mbikqyresesi i punimeve ka te drejte te kerkje kryerjen e provave te matrialeve te vendosura ne objekt, ku keto nuk jane kryer ne masen, sipas vellimeve te realizuara dhe pjeses se lendes se pare te furnizuar, per te verifikuar cilesine. Shpenzimet e ketyre provave jane ne ngarkim te sipermarresit

11. Kur mbikqyresi i punimeve mendon se ka difekte ne zbatimin e punimeve, kerkon verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte mbikqyresit te punimeve shpenzimet jane ne ngarkim te sipermarresit, ne rast te kundert, sipermarresi ka te drejte te kerkje shlyerjen e shpenzimeve.





**12.** Mbikqyresi ka te drejte te pezulojne perkohesisht punimet per zbatim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, ne cdo rast me miratimin e investitorit, per aq kohe sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

**13.** Mbikqyresi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut te hollesishem te punimeve dhe i raporton cdo muaji investitorit per realizimin e tij. Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikqyresit te punimeve. Sipermarresi duhet te njoftojne mbikqyresin kur punimet jane gati per tu ekzaminuar prej tij.

**14.** E gjithë korrespondenca e mbikqyresit te punimeve me investitorin dhe me sipermarresin, perben dokumentacionin e objektit dhe si e tille ruhet me cdo kusht. Mbikqyresi i punimeve mban dosjen e mbikqyerjes, ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtura gjate zbatimit te objektit, qe nga akti i dorezimit te sheshit te ndertimit, urdherat e ndryshem qe ka dhene gjate zbatimit te objektit, kundershite dhe kontraditatat e lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe kqne quar ne keto nderprerje, relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit si dhete gjithë rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjithe fazave te zbatimit te punimeve. Ne rastin e nderrimit te mbikqyeresit te punimeve kur ai terhiqet apo largohet nga investitori, mbahet proces verbal i dorezimit te dosjes se punimeve, ku shenohen edhe shkaqet e ketij nderrimi, dokumentacioni i mbikqyeresit te vjeter i dorezohet mbikqyeresit te ri.

**15.** Sipermarresi duhet te njoftoje me shkrim mbikqyresin per perfundimin e punimeve. Ne kete rast brenda 30 diteve, ai i paraqet mbikqyresit:

**a.** Kontraten dhe aktet qe lidhen me te.

**b.** Regjistrin e kontabilitetit.

**c.** Proces verbalet e fillimit, te nderprerjes ose te zgjatjes dhe te perfundimit te punimeve.


**d.** Deklarate se objekti eshte ndertuar ne perputhje me projektin teknik dhe me kushtet teknike te zbatimit.

**e.** Gjithe dokumentacionin teknik te zbatimit qe verteton ne volume dhe cilesi realizimin e tij sipas kerkesave te kushteve teknike te zbatimit te konfirmuar nga drejtuesi teknik i sipermarresit dhe drejtuesi i shoqerise. Per te gjitha problemete verifikuara rej tij mbikqyresi i punimeve duhet te firmos gjithcka qe ka miratuar. Ai mban pergjegjesi ligjore, se bashku me sipermarresin.

Nje kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikqyresi i punimeve i dergohet kolaudatorit te punimeve.

**16.** Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne kolaudimin e vepres, i pergjigjet kolaudatorit me te gjithë dokumentacionin e nevojshem per kolaudimin e vepres, si dhe firmos proces verbalin e ketij kolaudimi.

**17.** Situacionet e paraqitura nga sipermarresi, ne fazat e ndryshme te punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikqyresi i punimeve. Pagesat mund te kryhen vetem ne baze te ketij zbatimi.





18. Pas perfundimit te kolaudimit mbikqyresi i punimeve, mbeshtetur ne kontraten dhe dokumentacionin tjetër, percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e ditur sipërmarrësit si dhe i jepet per likuidim investitorit.

19. Mbikqyresesi i punimeve kontrollon dhe autorizon perdorimin e fondit rezerve te preventivuar si dhe i raporton gradualisht investitorit per realizimin e tij.

20. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundravajtje administrative, vendosen sanksione, ne baze te neneve 15 dhe 16 te kreut te III te ligjit nr.8402, date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit".

21. Pagesa e mbikqyresesit te punimeve do te behet ne perpjestim me vleren e realizuar ne objekt (Vleren e situacionit pjesor te punimeve).

### VIII. PERGJEGJESITE E INVESTITORIT

1. Te leshojne leje per futjen ne objekt te mbikqyresesit te punimeve ne cdo kohe.

2. Te sigurve kushte normale te domosdoshme per zbatimin e detyrave per mbikqyresin e punimeve.

3. Per te gjitha problemet qe mund te dalin gjate perjudhes se garancise se punimeve te kryera, mbikqyresesi eshte i detyruar te mbroje interesate e investitorit.

4. Investitori mund te kerkoje largimin nga puna te mbikqyresesit dhe zgjidhje te njeaneshme te kontrates dhe zëvedesimin e tij kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:

Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne piken VII te kesaj kontrate, ose nderprerjen e pa arsyzhime te punimeve dhe zgjatjen e theksuar te tyre, mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlere ne dem te cilesise.

### IX. PAGESA

Pagesa e mbikqyresesit te punimeve do te kryhet nga ana e investitorit, ne llogarine \_\_\_\_\_ te mbikqyresesit ne perpjestim me vleren e realizuar ne objekt (Vlera e situacionit pjesor), cdo pagese te paguhet me 95% te vleres se situacionit pjesor mujor te llogaritur. Pjesa prej 5% te paguhet pas perfundimit te aktit te kolaudimit te objektit.

### X. ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

1. Investitori dhe mbikqyresesi i punimeve duhet te bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur mosmarrveshjet me mirekuptim nepermjet bisedimeve per kete kontrate.

Ne qofte se mosmarrveshjet nuk zgjidhen me kete forme, atehere secila pale mund te kerkje zgjidhjen ne perputhje me ligjislacionin ne fuqi ne Gjykatën e Rrethit Gjygesor Kruje, ose Gjykatës Administrative



Kontrata u perpilua ne 5 kopje dhe firmoset nga te 2 shoqerite ne zbatim te kontrates se bashkepunimit si dhe Investitori. 1(nje) kopje sipermarresi, 1 (nje) kopje investitori dhe 1 (nje) kopje mbikqyresi, 1 (nje) kopje Zyra PKZHT te Komunes Nikel e cila do te beje edhe kontrollin e zbatimit te dosjes dhe 1 (nje) kopje ne protokollin e Komunes Nikel.

**INVESTITORI**

**MBIKQYRESI PUNIMEVE**

**KOMUNA NIKEL**

Perfaqesuar nga Kryetari Komunes

**IMES-D shpk&KLODIODA shpk**

Perfaqesuar me procure te posacme

Z. Ibrahim Dragoshi

**Z.RRAHMAN BRAJA**





Nr.00016636



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Departamenti i Përcaktimit dhe Dërgimit të Licencave Profesionale për Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari ndërtuese zbatimi

# L I C E N C E

MK.1641/3

## PER MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM PUNIMESH ZBATIMI

SHOQERIA: "IMES - D"

DREJTUES LIGJOR: IBRAHIM DRAGOSHI

DREJTUES TEKNIK: IBRAHIM DRAGOSHI, DHIMITRAQ LIÇO

ADRESA: TIRANE

Regjistruar në Regjistrin

themeltar që nga data: 15.04.2013

Kategoria Emergjenti i kategorise

NP-1	Punime gërmimi në tokë
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinasj civile e industriale, veshje fasada.
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikallme, fiekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP-7	Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vardiço.
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-1	Punime për prishien e ndërtimeve.
NS-2	Implante hidro - sanitare, kuzhiria, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lëshura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
NS-6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NS-7	Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
NS-15	Pastrimi i ujrave detarë, liqenor dhe lumor.
NS-16	Ndërtimi i implantëve të ujit të pishëm dhe pastrimit të tij.
NS-17	Ndërtimi i implantëve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.



KRYETARI I KOMISIONIT

Ymer SHLLAKU



**L I C E N C Ë**  
**MK.0773/7**

**PER MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM PUNIMESH ZBATIMI**

**SHOQËRIA: "K L O D I O D A"**

**DREJTUES LIGJOR:** YLLI KARAPICI  
**DREJTUES TEKNIK:** YLLI KARAPICI, NIKOLLAQ ALEKSI,  
 ANDI XHELEPI, AGIM SALA, STAK GJONI  
 ALMA SHEHU, VOJSAVA SINOIMERI

**ADRESA:** TIRANË

**Regjistruar në Regjistrin**  
**themeltar që nga data:** 15.04.2013

Kategoria	Emërtimi i kategorisë
NP-1	Punime çelimesh të toka
NP-2	Veprimtari civile dhe industriale
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
NP-4	Rregullim, mirëmbajtje, mbikëqim, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP-5	Punime në këmbim, ujrë e vepra arti.
NP-6	Diga dhe tunel hidroelektrikë
NP-7	Ujësjellës, gas, ujë, veshje, vepra kulturi e vaditje
NP-8	Kopime detare dhe punime themelimi në ujë
NP-9	Punime dhe mirëmbajtje lumora sisteme hidraulike dhe bonifikime.
NP-10	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
NP-11	Ndërtimi për N.S.H.C., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shtëpi ndarjet e energjisë.
NP-12	Punime të inzhinierisë së mjedisit
NP-13	Punime për prishjen e objekteve
NP-14	Implant hidr. - sanitare, kuzhina, lavantori, mirëmbajtja e tyre
NP-15	Ujësjellës dhe transportues (zeshensorë, shkallë levizëse, transportues).
NP-16	Proje dhe punime të marçurës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natës
NP-17	Implant të cilësimit dhe ndërtimit të trafikut
NP-18	Sisteme të mbrojtjes së mjedisit
NP-19	Bariera dhe mbrojtje bregdetore
NP-20	Ndërtimi parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
NP-21	Punime strukturore speciale
NP-22	Shtrësa dhe mbrojtje strukturore speciale.
NP-23	Punime mbrojtje dhe mbrojtje
NP-24	Implant teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
NP-25	Implant dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni.
NP-26	Implant të brendshme, elektrika, telefoni, radiotelefoni TV etj.
NP-27	Pastrimi i ujrave detare, lagunor dhe lumor.
NP-28	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
NP-29	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
NP-30	Punime topogjeodezike
NP-31	Sistemet kundër zhumës për infrastrukturë
NP-32	Shpime gjeologjike, inzhinierike, puse e shpime për ujë.



**KRYETARI I KOMITETIT**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA DURRES  
NR 2124 REP  
NR 783 KOL



Taksa e Pulles e Paguar

### Kontrate Bashkepunimi

Sot me daten 28.09.2014 (dy mije e katermbedhete), para meje noteres Manushaqe Jaupi, Anetare e Dhomes se Noterve Durres u paraqiten personalisht palet:

SHOQERIA "IMES-D" sh.p.k. regjistruar si person juridik me Nipt K82430006C, perfaqesuar nga admionistratori i saj z.Ibrahim Dragoshi, i biri i Tahsimit i datelindjes 10.07.1963, lindur ne Kukes banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftim ID 025862015 dhe me nr.personal G30710109U.

SHOQERIA "KLODIODA" shpk, regjistruar me Nipt K51813002H, perfaqesuar nga administratori dhe ortaku i vetem Ylli Karapici i biri i Rexhepit i datelindjes 30.12.1970, lindur ne Tirane banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftim ID 024937459 dhe me nr.personal H01230082H.

Te dy shoqerite e mesiperme rane dakort qe te lidhin nje kontrate bashkepunimi me kushtet si vijon:

#### OBJEKTI I KONTRATES

Palet kontraktuese lidhin kontraten e bashkepunimit midis tyre per pjesemarrje ne tender per nje afat kohor 1 vjecar, ne fushen e Projektimit dhe Supervizionit.

#### KUSHTET E KONTRATES

Shoqeria "IMES-D" sh.p.k. dhe "KLODIODA" shpk me marreveshje do te vendosin ne aktet e perfaqesimit, objektin e punes, perqindjet e punimeve, si dhe menyren e ndarjes se fitimit.

#### DETYRIMET E PALEVE KONTRAKTUESE

Palet Kontraktuese, secila sipas marreveshjes, secila do te leshoje prokure te posacme per perfaqesimin ne tender dhe kryerjen e procedurave ligjore perkatese. Mjetet financare do te vendosen bashkerisht nga shoqerite e mesiperme.





Shoqeria qe sipas marreveshjes do te jete Kontraktor i pare do te mbaje pergjegjesi para investitorit dhe gjithë instancave per realizimin me sukses te te gjitha detyrimeve te Kontartes (ne rastet te fitimit te tenderit).

### DISPOZITA TE FUNDIT

Per porblemet e tjera qe mund te dalin gjate procesit te bashkepunimit, palet do te merren vesh midis tyre, duke bere marreveshje me shkrim, nese kjo do konsiderohet e nevojshme prej tyre.

Kontrata u redaktua në zbatim të kërkesa të ligjit "Për Prokurimin Publik" Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar së fundi me Ligjin Nr.131, datë 27.12.2012, dhe udhëzimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi, si dhe nenet 79, 659 e vijues të K.Civil, dhe Ligjit "Për Noterinë" me ndryshimet përkatëse.

Kontrata u redaktua në tre kopje me fuqi të njëjta ligjore, origjinale, dy kopje nga të cilat u jepen palëve, dhe një kopje arkivohet në arkivin e kësaj zyre.

Kontrata u përpilua nga unë noteri, u lexua me zë të lartë dhe pasi ajo u gjet sipas ligjit dhe vullnetit të lirë të palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time.

Unë noterja pasi u binda për vullnetin e deklaramit, në bazë të Ligjit Nr.7829, datë 01.06.1994 «Për noterinë» i (ndryshuar) vërtetoj nënshkrimet.

### PALET

Shoqeria "IMES-D" shpk  
Administratori  
Ibrahim Dragoshi

IBRAHIM DRAGOSHI



Shoqeria "KLODIODA" Shpk  
Administratori  
Ylli Karapici



NOTERE

Manushaqe JAUPI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA DURRES  
NR 7125 REP  
NR 184 KOL



## PROKURE E POSAÇME

Sot me daten 28.09.2014 (dy mijë e katërmbedhjetë), para meje noteres Manushaqe JAUPI, u paraqiten personalisht palet:

SHOQERIA "KLODIODA" shpk, regjistruar me Nipt K51813002H, perfaqesuar nga administratori dhe ortaku i vetem Ylli Karapici i biri i Rexhepit i datelindjes 30.12.1970, lindur ne Tirane banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftim ID 024937459, e cila emron perfaqesues ligjor:

Shoqerine "IMES-D" sh.p.k. regjistruar si person juridik me Nipt K82430006C, perfaqesuar nga admionistratori i saj z.Ibrahim Dragoshi, i biri i Tahsimit i datelindjes 10.07.1963, lindur ne Kukës banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftim ID 025862015

Perfaqesuesi i ngarkuar me kete prokure, ne emer dhe per llogari te ketij bashkimi te shoqerive, ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme, te kerkoje dhe te paraqese te gjithë dokumentacionin e duhur, te perfaqesoje kete bashkim te shoqerive ne tenderin me objekt:

### **Mbikqyrje Punimesh per Rikonstruksionin e shkolles se mesme Ramazan Karaj**

Shoqeria "IMES-D" sh.p.k. merr persiper te kryeje 90% te punimeve ndersa shoqeria KLODIODA sh.p.k. merr persiper 10% te punimeve te vleres se kontrates. Ne po keto raporte do te behet edhe shperndarja e fitimit midis paleve kontarktuese.

Perfaqesuesi ka te drejte te lidhe kontraten me Entin Prokurues, si dhe te kryeje te gjitha veprimet finaciare dhe teknike per llogari te ketij bashkimi.

Te gjitha veprimet qe do te kryeje perfaqesuesi, shoqeria "IMES-D" shpk ne emer te bashkimit te shoqerive, do t'i konsiderojme te drejta dhe si te kryera prej nesh.

Kjo prokure eshte e vlefshme deri ne perfundimin e punimeve te objektit te cituar me siper. Per vertetimin e sa me siper u hartua kjo prokure e posacme, e cila pasi u lexua qarte dhe me ze te larte, dhe pasi ata rane dakort me permbajtjen e saj, e nenshkroi ate rregullisht ne pranine time.

Une noteri pasi u binda per vullnetin e dekarimit, lejova nenshkrimin dhe vertetoj ato sipas ligjit.

I PERFAQESUARI  
Ylli Karapici

NOTERE  
Manushaqe JAUPI

*Ylli Karapici*

*Manushaqe Jaupi*





### Mbi konfliktin e interesave

Të operatorit ekonomik IMES-D pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik të zhvilluar në datë 26.09.2014 nga Autoriteti Kontraktor : Komuna Nikel me objekt: ” **Rikonstruksion Shkolla e Mesme “Ramazan Karaj”** me fond limit. 355.288 (treqind e pesedhjetë e pese mije e dyqind e njezet e tete)leke pa TVSH. Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiave të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.**

Unë i nënshkruari **Ibrahim Dragoshi**, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik “IMES-D “ sh.p.k deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në





**DEKLARATË**  
**Mbi konfliktin e interesave**

Të operatorit ekonomik Klodioda sh.p.k. pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik të zhvilluar në date 26.09.2014 nga Autoriteti Kontraktor "Komuna Nikel" me objekt "Mbikqyrjen e punimeve ne objektin: Rikonstruksion Shkolla e Mesme "Ramazan Karaj" me fond limit Fond Limit 355 288 (treqind e pesedhete e pese mije e dyqind e tetedhete e tete) lekë pa TVSH.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zv.kryeministri, ministrat, ose zv.ministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasuriven, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.





Unë i nënshkruari Ylli Karapici, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik "Klodioda" sh.p.k. deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës 26.09.2014

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

"KLODIODA" sh.p.k.

Administratori

Ylli Karapici

